

Njoftim i përqendrimit me të cilin RAUCH FRUCHTSAFTE GMBH, Republika e Austrisë do të fitojë kontrollin mbi VITA RES SHPK IMPORT-EKSPORT RESEN, Republika e Maqedonisë së Veriut

(lënda nr. 08-109/2024)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 25.07. 2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilën RAUCH FRUCHTSAFTE GMBH, me seli në LANGGASSE 1, 6830 RankVeil, Republika e Austrisë, synon të fitojë kontroll të pavarur mbi Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime VITA RES DOO IMPORT-EKSPORT RESEN, me seli të regjistruar në rr. 29 nëntor nr. 1/26, Resen, 1, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Pjesëmarrësit e përqendrimit dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

RAUCH FRUCHTSAFTE është një shoqëri e themeluar në përputhje me ligjet e Republikës së Austrisë, me selinë e regjistruar të LANGGASSE 1, 6830 Rankveil, Republika e Austrisë, me numër regjistrimi FN 68604 p dhe një shoqëri që është pjesë e Grupit të Ndërmarrjeve RAUCH.

Në përgjithësi, Grupi i Ndërmarrjeve RAUCH FRUCHTSAFTE zë tre fusha strategjike të biznesit.

Përveç prodhimit dhe shitjes së markave Rauch nga “Happy Day” në “Bravo”, “Nativa” dhe “Rauch IceTea”, Rauch është etabluar edhe në segmentin B2B.

Në kuadër të kësaj dege, kompania Rauch ka rolin e një kompanie prodhuese dhe shitëse për blerësit ndërkombëtarë të koncentrateve të frutave dhe produkteve gjysmë të gatshme.

Fusha e tretë i referohet tarifave për licencë. Si një ofrues shërbimi, Rauch plotëson prodhuesit e tjerë të pijeve me ekspertizën e tij dhe sistemet dhe linjat më të mira për mbushjen e kanoçeve, PET (plastike), karton (p.sh. Tetra Pak) dhe shishe qelqi.

RAUCH FRUCHTSAFTE aktualisht ka kontroll mbi shoqëri të shumta nga të cilat mund të përcaktohet VITA RES është drejtpërdrejt aktive në sektorin e përpunimit të frutave dhe prodhimin e produkteve të përfutuara nga përpunimi i frutave (koncentrate frutash, pure frutash dhe kube të ngrira frutash). VITA RES nuk ka kontroll në kompani të tjera.

VITA RES plasun produkte në treg në Evropë dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Aktivitetet e VITA RES në sektorin e përpunimit të frutave dhe prodhimit të produkteve të përfutuara nga përpunimi i frutave dhe perimeve (koncentrate frutash, pure frutash dhe kube të ngrira frutash) ndodhen në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Të ardhurat totale të VITA RES të realizuara në Maqedoninë e Veriut kanë të bëjnë kryesisht me shitjen e produkteve gjysmë të gatshme të përfutuara nga përpunimi i frutave (koncentrate frutash, pure frutash dhe kube të ngrira frutash).

Parashtruesi i njoftimit, propozon, si treg relevant për vlerësimin e përqendrimit në fjalë, të përcaktohet tregu i përpunimit të frutave dhe prodhimit të produkteve gjysmë të gatshme të frutave (koncentrate frutash, pure frutash dhe kube frutash të ngrira).

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

30.07.2024

Shkup